

VENDIM
Nr. 880, datë 30.9.2013

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 591, DATË 10.7.2013 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE, PËR VITIN 2013”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2005 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 10 të ligjit nr. 119/2013 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7 të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga rregullat e përcaktuara në pikat 6 e 7 të këtij vendimi, për:

a) stërvitjet ose veprimtaritë ushtarake ndërkombëtare, të organizuara, të autorizuar ose të drejtuara nga NATO-ja, Bashkimi Evropian ose vende anëtare të marrëveshjes PfP SOFA;

b) konferencat planëzuese të misioneve, në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar;

c) trajnimet për modernizimin e Forcave të Armatosura, të planëzuara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

ç) veprimtaritë e personelit, ushtarak dhe civil, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake në strukturat e NATO-s.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama